VENDIM
Nr. 481, datë 26.6.2026

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E HARTIMIT TË PROJEKTEVE TË NDËRHYRJEVE REHABILITUESE/PËRSHTATËSE PËR NDËRHYRJET STRUKTURALE TË NEVOJSHME PËR OBJEKTET ME SHKALLË DËMTUESHMËRIE DS4 NË BASHKINË KURBIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nënndarjes "i", të shkronjës "b, të nenit 13, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 5 988 250 (pesë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projekteve të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar me shkallë dëmtueshmërie DS4 në Bashkinë Kurbin.
2. Efekti financiar përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026, dhe i transferohet Bashkisë Kurbin në formën e transfertës së pakushtëzuar.
3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu